Në zbatim të ligjit nr. 99, datë 12.09.2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Inspektorati i Përgjithshëm ka për mision të sigurojë përmirësimin dhe rritjen e nivelit të efektivitetit dhe përgjegjshmërisë gjatë kryerjes së veprimtarisë së inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

Inspektorati i Përgjithshëm është institucion publik qendror buxhetor, me seli në Tiranë, në varësi të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit dhe financohet nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Inspektorati i Përgjithshëm ka si funksion:

- të miratojë dhe aplikojë rregulla për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit, si dhe të raportojë veprimtarinë e inspektorateve;

-të krijojë një bazë të dhënash të qendërzuar, me profile individuale të subjekteve të inspektimit, me qëllim përmirësimin dhe rritjen e efektivitetit të inspektimeve, në respektim të parimeve të ligjit;

- të koordinojë dhe monitorojë veprimtaritë e inspektimit; - të monitorojë zbatimin e politikave dhe standardeve të inspektimit, të miratuara nga Bordi i Inspektimeve, si edhe të treguesve të performancës në fushën e inspektimit;

- të raportojë përpara Bordit të Inspektimeve për çështjet që janë në funksion të këtij të fundit;

- të japë mendime për çdo nismë ligjore dhe nënligjore në fushën e inspektimit;

-të fillojë menjëherë procedurën për ngritjen e komisionit disiplinor, kur konstaton shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore gjatë ushtrimit të detyrës nga inspektorët e të gjitha niveleve;

-të kryejë trajnimin, kualifikimin dhe certifikimin e inspektorëve, në bashkërendim me inspektoratet qendrore dhe vendore;

-të administrojë dhe përdorë sistemin unik elektronik të inspektimit, që shërben për kryerjen e veprimtarisë inspektuese, shkëmbimin e të dhënave ndërmjet inspektorateve qendrore dhe vendore dhe bazës së të dhënave të institucioneve të tjera;

-të përcaktojë llojet e mjeteve teknologjike për kryerjen e veprimtarisë inspektuese online;

-të trajtojë të gjitha informacionet, ankesat dhe denoncimet e ardhura nga qytetarë ose persona fizikë apo juridikë për veprimtaritë e inspektorëve, si dhe procedurat e inspektimit të drejtuara, sipas formave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, përfshirë edhe ankesat që kryhen në platformën ndërqeveritare të ndërveprimit;

-të miratojë çdo kërkesë nga inspektoratet qendrore dhe vendore për zbatimin, ndryshimin

apo veprimet në sistemin unik “e-Inspektimi”;

-të lëshojë kartën e inspektorit për inspektoratet qendrore, ndërsa për inspektoratet vendore lëshimi kryhet nga kryetari i bashkisë;

- të përcaktojë rregullat për realizimin e veprimtarisë inspektuese në raste të jashtëzakonshme, kur nuk është i mundur përdorimi i sistemit elektronik të inspektimit;

- të mbikëqyrë në terren procedurën e inspektimit të inspektorateve qendrore dhe vendore.

Për inspektoratet qendrore, Inspektorati i Përgjithshëm ka si funksion:

-të japë mendim këshillimor për programet vjetore dhe të miratojë programet mujore të inspektimit, të hartuara nga inspektoratet qendrore;

-të bashkërendojë dhe mbikëqyrë ligjshmërinë e veprimtarive inspektuese të inspektorateve qendrore;

-të mbikëqyrë zbatimin e kërkesave ligjore nga inspektorët qendrorë për programimin, autorizimin dhe kryerjen e procesit të inspektimit;

- të japë mendim brenda 10 ditëve pune nga data e paraqitjes për programet buxhetore afatmesme dhe afatgjata, të hartuara nga inspektoratet qendrore;

- të kryejë procedurat për ngritjen e komisionit të rekrutimit dhe ngritjes në detyrë të inspektorëve, komisionit disiplinor, si dhe komisionit të ankimit për vendimin përfundimtar.

Për inspektoratet vendore, Inspektorati i Përgjithshëm ka si funksion:

-të koordinojë dhe mbikëqyrë ligjshmërinë e veprimtarive inspektuese të inspektorateve vendore, të shmangë mbivendosjet e kompetencave me inspektoratet qendrore, si dhe të mbikëqyrë procedurat e rekrutimit, ankimit dhe largimit të inspektorëve vendorë nga detyra, me qëllim garantimin e respektimit të standardeve në fushën e inspektimit;

- të mbikëqyrë zbatimin e kërkesave ligjore nga inspektorët vendorë për programimin, autorizimin dhe kryerjen e procesit të inspektimit.